

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në përbërje: Mr. Borçe Razmoski–Kryetar, Mr. Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgaçevski, Nikolla Trajçevski dhe Valon Elezi-anëtarë duke vepruar sipas detyrës zyrtare kundër Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir, me seli në rr. „Petar Petroviq Njegosh” nr.131, Manastir, e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Menkinoski nga Shkupi, për shkak të konstatimit të kundërvajtjes së kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në seancën e mbajtur më 11.07.2025 sollli këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir, me seli në rr. „Petar Petroviq Njegosh” nr.131, Manastir, e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Menkinoski nga Shkupi, me NUAS:4171543, NUT: 4002990100656, xhiro-llogaria nr. 500000000024180 në Stopanska Banka SHA Manastir nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 01.11.2023 të Komisionit në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar në afatin e përcaktuar i cili skadonte më 12.11.2023, si ditë deri kur Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir ishte e detyruar t'i dorëzonte të dhënat e kërkuara dhe me këtë ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, për çka i shqiptohet sanksion – gjobë në shumë prej 60.000,00 denarë, që paraqet 0,04387% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

2. Gjobën nga pika 1) të këtij vendimi kryerësit e kundërvajtjes janë të detyruar ta paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në llogarinë e transaksionit të pranuesit të urdhrit: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx07337 - gjoba për kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës, me shifër të të ardhurave 722139 dhe program 00, pranues i urdhrit - Ministria e Financave, banka e pranuesit – BPRMV dhe deri te Komisioni për Vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës të dorëzojë dëshmi/kopje nga pagesa e kryer e gjobës në afat prej 15 ditësh nga pagesa e kryer. Gjoba e papaguar ose e papaguar në kohë, do të arkëtohet në rrugë të detyrueshme. Padia e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me shkresën nr.08-21 të datës 15.04.2024 deri te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dorëzoi kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Me kërkesën, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkon që Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës të fillojë procedurë sipas detyrës zyrtare ndër të tjera edhe Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike,

komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir, me seli në rr. „Petar Petroviq Njegosh” nr.131, Manastir me NUAS:4171543 dhe numër unik tatimor:4002990100656 e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Menkinoski nga Shkupi, për shkak të mosveprimit sipas konkluzionit nr.08-98 të 01.11.2023 për dorëzimin e të dhënave në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 49 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, që paraqet kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Konkluzioni për dorëzimin e të dhënave PK nr.08-98 të datës 01.11.2023 i është dorëzuar EKO KLUB SHPKNJP, Manastir, ndërmarrje e cila në ditën 03.04.2020 ka bërë ndryshim të emrit të firmës në Shoqëri tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir, e dukshme nga Historiku i ndryshimeve i siguruar nga Regjistri Qendror. E dukshme nga fletë kthimi përkatësisht raporti për dorëzim nga Postat e Maqedonisë, subjekti i theksuar e ka pranuar Konkluzionin e lartpërmendur në ditën 03.11.2023.

Më tej në kërkesë theksohet se EKO KLUB SHPKNJP, Manastir, me seli në rr. „Petar Petroviq Njegosh” nr.13, Manastir deri te Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës nuk i ka dorëzuar të dhënat e nevojshme, në afatin e përcaktuar ligjor prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit nr.08-98 të datës 01.11.2023, përkatësisht nuk ka dorëzuar: Sasitë e përgjithshme të blera të letrës së mbeturinave nga persona fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/mbledhura të letrës së mbeturinave nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/mbledhura të letrës së mbeturinave nga subjekte të tjera (të theksohet cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera të plastikës së mbeturinave nga persona fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; -Sasitë e përgjithshme të blera/mbledhura të plastikës së mbeturinave nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/mbledhura të plastikës së mbeturinave nga subjekte të tjera (të theksohet cilat) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera të qelqit të mbeturinave nga persona fizikë (mbledhës joformalë) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/mbledhura të qelqit të mbeturinave nga subjekte juridike (krijues të mbeturinave) nga territori i qytetit të Shkupit; Sasitë e përgjithshme të blera/mbledhura të qelqit nga subjekte të tjera (të theksohet cilat) nga territori i qytetit të Shkupit.

Qëllimi i sigurimit të të dhënave ka qenë që Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, si organ kompetent për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Ligji për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.208/24 dhe 16/25) të kryejë vlerësim të drejtë të njoftimit të dorëzuar për përqendrim ndërmjet KAPKA STAR RESAJKLING SHPK, Umka Serbi dhe NUTRIVET SHPK Shkup, të cilët kishin për qëllim të kryenin bashkimin e biznesit për mbledhje, transport, magazinim dhe trajtim të mbeturinave jo të rrezikshme të NUTRIVET SHPK Shkup me biznesin e EKO STAR RECIKLAZHA SHPKNJP Shkup.

Duke marrë parasysh faktin se EKO KLUB SHPKNJP Manastir, përkatësisht tani i riemërtuar në Shoqëri tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir konkluzionin nr.08-98 të datës 01.11.2023 e ka pranuar më 03.11.2023 dhe nuk ka vepruar sipas konkluzionit, përkatësisht nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara, në afatin e përcaktuar, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës kërkoi që Komisioni për Vendimmarrje për kundërvajtje si organ i cili zhvillon procedurën kundërvajtëse para Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës dhe shqipton sanksion kundërvajtës për kundërvajtjet

e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, sipas detyrës zyrtare të fillojë procedurë kundërvajtëse kundër Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir, për shkak të konstatimit të kundërvajtjes eventuale nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës..

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, dhe për shkak se Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir nuk ka vepruar në afatin ligjor të përcaktuar për përgjigje sipas Konkluzionit 08-98 të datës 01.11.2023 KVK pranë Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës, në seancë të mbajtur në ditën 21.02.2025, solli Konkluzion për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr.09-40/1 me të cilin Konkluzion, KVK kërkoi që Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir t'i dorëzojë KVK-së dokumentet dhe të dhënat në vijim: Ekstrakt nga Regjistri Qendror për gjendjen rrjedhëse; Bilancin e suksesit për vitin 2023 dhe Të dhëna për xhiro - llogarinë, numrin unik tatimor dhe deponentin – bankën në afat prej 8 ditësh.

Konkluzioni është dorëzuar me letër shoqëruese PK nr.09-40/2 të datës 21.02.2025

Në ditën 25.03.2025 Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir dorëzoi marrëveshje (përgjigje) ndaj Konkluzionit për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr.09-40/3 dhe me të njëjtën i dorëzoi të dhënat dhe dokumentet e kërkuara.

Në përgjigjen ndaj konkluzionit theksohet se nuk janë përmbushur bazat ligjore për shqiptimin e sanksionit kundërvajtës, për arsye se Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir konkluzionin nr.08-98 të 01.11.2023 kurrë nuk e ka pranuar, përkatësisht se janë të pasakta pretendimet e KVK-së se i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt në ditën 03.11.2023.

Lidhur me fletë kthimin për dorëzim të rregullt të Konkluzionit nr.08-98 të datës 01.11.2023 nga Postat e Maqedonisë Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir thekson se në të njëjtin nuk përmbahet vula e personit juridik për praninë të rregullt të konkluzionit dhe për këto arsye i propozojnë KVK-së të sjellë vendim me të cilin do të konstatojë se Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir nuk ka kryer kundërvajtje të paraparë me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Në ditën 04.04.2025 Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës pranë Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje solli Njoftim paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr.09-40/5.

Njoftimi paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr.09-40/5 është dorëzuar me letër shoqëruese PK nr.09-40/6 të datës 07.04.2025.

Në ditën 29.04.2025 i autorizuari i Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir dorëzoi Parashtresë-deklarim PK nr.09-40/7 ndaj njoftimit paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar.

Në përgjigje theksohet se konkluzioni i Komisionit nr.08-98 të datës 01.11.2023 i është dorëzuar personit juridik EKO KLUB SHPKNJP Manastir, emri i të cilit është ndërruar më

29.04.2020, dhe jo me emrin e ri të shoqërisë- Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir. Gjithashtu theksohet se e dukshme edhe nga fletë kthimi nga Postat e Maqedonisë për pranimin e pretenduar të konkluzionit të lartpërmendur nuk përmbahet vullë e personit juridik REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir, ndërsa nënshkrimi në të njëjtën nuk është i personit juridik i cili me autorizim të rregullt të lëshuar nga ana e REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir në postat e Maqedonisë në vitin 2023 dhe të njëjtin e propozuan deri te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës kërkon që Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të nxirret si provë në procedurë. Në bazë të lartpërmendurës, REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir i propozoi Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të sjellë vendim me të cilin do të konstatojë se Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir nuk ka kryer kundërvajtje të paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në ditën 30.05.2025 Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës pranë Komisionit për Vendimmarrje për kundërvajtje solli Njoftim përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-40/8.

Njoftimi përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar PK nr. 09-40/8 është dorëzuar me letër shoqëruese PK nr.09-40/9 të datës 30.05.2025. Në ditën 23.06.2025 i autorizuari i REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir dorëzoi te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje Parashtrësë-Plotësim i deklaramit në lidhje me Njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar.

Në ditën 26.06.2025 i autorizuari i Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir përsëri e dorëzoi të njëjtën shkresë-përkatësisht Parashtrësë-deklarim, tani e vërtetuar me numër arkivor PK nr.09-40/11 e cila ka të bëjë me Njoftimin paraprak për gjendjen faktike të vërtetuar.

Pas sigurimit të të dhënave të nevojshme me rëndësi për Vendimmarrje të drejtë në procedurën kundërvajtëse dhe nga provat e mbledhura në vendngjarje, si dhe nga deklarimi për deklarimin paraprak dhe përfundimtar për gjendjen faktike të vërtetuar të Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir KVK konstatoi se:

Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir nuk ka vepruar sipas Konkluzionit për dorëzimin e të dhënave nr. 08-98 të datës 01.11.2023 të Komisionit në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 49 të Ligjit, në atë mënyrë që nuk i ka dorëzuar të dhënat e kërkuara me konkluzionin e theksuar në afatin e përcaktuar i cili skadonte më 12.11.2023, si ditë deri kur Shoqëria tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir ishte e detyruar t'i dorëzonte të dhënat e kërkuara dhe me atë **ka kryer kundërvajtje nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Sipas nenit 61 paragrafi (1) të LMK, KVK ndërmarrjes, përkatësisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në shumë deri në 1% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin e fundit afarist, e shprehur në vlerë absolute dhe nominale për të cilën ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve ka përpiluar llogari vjetore nëse:

-Nuk vepron sipas konkluzionit të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës ose Komisionit për Vendimmarrje për kundërvajtje për dorëzimin e të dhënave në afatin e përcaktuar, dhe në kuptim të nenit 40, nenit 48 dhe nenit 49 të këtij ligji;

Të ardhurat e përgjithshme të Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir të realizuara në vitin 2024 arrijnë 136.760.686,00 denarë.

Në përcaktimin e shumës së gjobës, sipas nenit 64 të Ligjit, Komisioni për Vendimmarrje për kundërvajtje pranë Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës do të marrë parasysh rëndësinë e kundërvajtjes, kohëzgjatjen e kundërvajtjes dhe shkallën e shkeljes së konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës konstatoi se shumica e gjobës e cila i shqiptohet Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir për kundërvajtje të kryer nga neni 61 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës arrin 60.000,00 denarë, që paraqet 0,04387% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Shoqërisë tregtare për shërbime ekologjike, komunale dhe të tjera REMONDIS MEDISON SHPKNJP Manastir të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka përpiluar llogari vjetore.

Për shkak të gjithë asaj të lartpërmendur u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски